



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË**

---

Numri i lëndës: 2021:092674

Datë: 17.05.2022

Numri i dokumentit: 03021946

PPP.nr.1010/21

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË DEGA NË MALISHEVË, gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit R. O.S.. ... T., R.. e Gj., të cilin me autorizim e përfaqëson Av. A. I. nga P., kundër debitorit H.M. nga M., Rr.“R.K.” pn, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit me numër P.nr.23/2021, të datës 07.04.2021, të lëshuar nga Përmbaruesit privat, Y. K.nga M., jashtë seancës gjyqësore, me datë 17.05.2022, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

PRANOHET prapësimi i debitorit H.M. nga M. dhe ANULOHET urdhri për lejimin e përmbarimit numër P.nr.23/21 i datës 07.04.2021, i lëshuar nga Përmbaruesi Privat Y.K., nga M., dhe PËRFUNDOHET çështja në këtë procedurë përmbarimore.

**A r s y e t i m**

Përmbaruesi Privat Y. K. nga M. (me seli në M.), duke vepruar sipas propozimit të kreditorit R. O. S.. ... T., R.. e Gj., të cilin e përfaqëson A.I., avokat nga P., me datë 07.04.2021 ka lëshuar Urdhrin përmbarimor P.nr.23/21, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarimor – aktvendimit të formës së prerë dhe të ekzekutueshëm të Gjykatës Themelore Gjakovë Dega në

M. CN.nr.39/20 i dt.24.02.2021, me të cilin ka kërkuar që debitori të obligohet që kreditorit t'ia paguaj borxhin në shumën prej 2,244.26 euro përkatësisht siç është përshkruar në Aktvendimin nr. ... i datës 09.12.2016.

Kundër urdhrimit për lejimin e përmbarimit, brenda afatit ligjor me datë 19.04.2021, prapësim ka paraqitur debitori, me të cilin e kundërshtuar kërkesën e kreditorit për përmbarim, për shkak se debitori borxhin e ka paguar në kohën që ka qenë në Gj. ndërsa në fund të vitit 2016 është kthyer në Kosovë dhe nuk ka pasur asnjë borxh ndaj shtetit të Gj.. Më tej ka shtuar se menjëherë pas marrjes së këtij dokumenti për përmbarim, debitori ka kërkuar nga banka gjermane që të dëshmoj dhe të tregoj gjendjen e llogarisë për vitit 2016, sipas të cilës është bërë pagesa, duke shtuar se edhe nëse ka ekzistuar ky borxh tani më për të njëjtin është parashkruar e drejta e përmbarimit sepse kanë kaluar më tepër se pesë vite, ndërsa pala kreditore nuk ka ndërmarrë asnjë veprim. Gjykatës i ka propozuar prishjen e urdhrimit përmbarues.

I autorizuari i kreditorit ka parashtruar përgjigje në prapësimin e debitorit, në të cilin ka deklaruar se pretendimi i debitorit i paraqitur kundër urdhrimit përmbarimor me arsyetimin se këtë borxh debitori e ka paguar në vitin 2016 kur ka qenë në Gj., është i pa pranueshëm, i pa bazuar dhe i kundërligjshëm, për arsye se debitori nuk e ka mbështetur këtë bazë për prapësim me prova të duhura siç parashikohet me dispozitat e LPP-së, po ashtu është i pa pranueshëm dhe i kundërligjshëm pretendimi i debitorit me pretekst se ka kërkuar nga banka gjermane që atij t'ia dërgoj gjendjen e llogarisë për vitin 2016 me të cilën do të shihej se e ka paguar borxhin e theksuar, po ashtu pretendimi i debitorit se ky borxh është parashkruar bie ndesh me dispozitat ligjore të LMD-së, nga gjykata ka kërkuar që prapësimi i debitorit i paraqitur kundër urdhrimit për përmbarim të refuzohet .

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi është i bazuar, nga këto arsye:

Gjykata vlerëson se propozimi i kreditorit është ushtruar duke u bazuar në Aktvendimin e Gjykatës Themelore Gjakovë, Dega M. CN.nr. 39/2020 i datës 24.02.2021, sipas të cilit aktvendim pranohet (njihet) Aktvendimi për Ekzekutimin e përmbarimit 16-7875686-0-8N i datës 10.04.2019, i Gjykatës Themelore Departamenti i Përmbarimeve në C. R. e Gj..

Pas analizimit dhe vlerësimit të urdhrin për përmbarim dhe shkresave të lëndës, gjykata gjeti se urdhri për përmbarim P.nr. 23/21 i datës 07.04.2021 i Përmbaruesit Privat Y. K., është lejuar mbi bazën e një dokumenti i cili nuk ka tipare të dokumentit përmbarimor, andaj urdhri nuk është i përshtatshëm për përmbarim, konform nenit 22 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5, dhe nenit 38 paragrafi 1 të LPP-së.

Gjykata, duke vlerësuar urdhrin për përmbarim – dokumentin përmbarimor, gjeti se propozimi për përmbarim bazohet në Aktvendimin e Gjykatës Themelore Gj. – Dega M. CN.nr. 39/20 i datës 24.02.2021, i cili nuk i plotëson kushtet për lejueshmërinë e përmbarimit, sepse nuk bënë pjesë në kuadër të dokumenteve përmbarimore siç parashihet me nenin 22 paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të LPP-së: *“aktvendimet, aktet dhe memorandumet për ujdite gjyqësore të Gjykatave të huaja si dhe vendimet e Gjykatave të huaja të arbitrazhit dhe ujdite e arritura para Gjykatave të tilla në raste të arbitrazhit, të cilat janë pranuar për përmbarim brenda territorit të Republikës së Kosovës”*.

Me nenin 38 paragrafi 1 të LPP-së, është përcaktuar se: *“Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi, kërkuesi i përmbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjete nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarimi, objekti i përmbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit ”*, ndërsa në rastin konkret propozimi për përmbarim është bazuar në një vendim që nuk i përmban tiparet e dokumentit përmbarues, pasi që në referatin e propozimit ceket se borxhi është vërtetuar sipas Aktvendimit nr. 16-7875686-0-8N i datës 10.04.2019 i Gjykatës Themelore Departamenti i Përmbarimeve në C. R. e Gj. dhe se ky vendim si titull përmbarimor, vetëm është njohur si vendim i huaj nga Gjykata Themelore Gjakovë Dega Malishevë CN.nr. 39/20 datës 24.02.2021.

Gjykata vlerëson se dokumenti përmbarues Aktvendimit të Gjykatës Themelore Gjakovë Dega M. CN.nr. 39/2020 i datës 24.02.2021, mbi bazën e të cilit përmbaruesi privat ka lëshuar urdhrin përmbarimor, nuk i përmban tiparet e dokumentit përmbarues, nuk ka titull ekzekutiv, konform nenit 27 par. 1 të LPP-së, me të cilin është përcaktuar se: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.”*, ndërsa me këtë vendim është bërë vetëm njohja e vendimit të huaj, mirëpo detyrimi i debitorit ndaj kreditorit, objekti i detyrimit, mjetet, shuma

dhe koha e detyrimit, nuk janë përcaktuar dhe nuk kanë rrjedhur mbi bazën e këtij vendimi, andaj si i tillë ky dokument nuk mund të trajtohet si dokument përmbarimor.

Andaj, gjykata vlerëson se dokumenti përmbarimor në bazë të cilit është lëshuar urdhri nga përmbaruesi privat, nuk i plotëson kushtet për përmbarim që duhet t'i ketë dokumenti përmbarimor, të parapara me nenin 24 paragrafi 1 dhe 27 të LPP-së, pasi që propozimi bazohet në një vendim që nuk i përmban tiparet e dokumentit përmbarues.

Në kuptim të dispozitave të lartcekura, e duke pasur parasysh shkresat e lëndës, Gjykata gjen se përmbaruesi privat ka lëshuar urdhrin për përmbarim në bazë të vendimit të Gjykatës Themelore Gj. Dega M. CN.nr. 39/20 i datës 24.02.2021.

Sipas kësaj Gjykate, përmbaruesi privat i cili vepron në procedurën përmbarimore si organ i shkallës së parë, ka pasur për obligim që ta shqyrtojë propozimin për përmbarim dhe ta vlerësojë atë krahas dokumentit përmbarues mbi të cilin është bërë propozimi, si organ i shkallës së parë, i cili merr vendime në procedurën përmbarimore, përmbaruesi privat ka pasur për obligim të vlerësojë nëse dokumenti përmbarues mbi të cilin është bazuar propozimi për përmbarim a i plotëson kushtet ligjore të përmbarueshmërisë, e pastaj të caktojë urdhrin për përmbarim.

Gjykata vlerëson se urdhri i lartcekur nuk gjen mbështetje në dispozitat e LPP-së, pasi që përmbaruesi privat, ka caktuar përmbarimin në bazë të një dokumenti i cili nuk është dokument përmbarimor konform dispozitave të nenit 22 të LPP-së, dhe nuk i ka plotësuar kushtet që kërkohen sipas nenit 38 të LPP-së, si i tillë ky dokument nuk mund të trajtohet si dokument përmbarimor.

Nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në kuptim të dispozitave ligjore të cekura më lartë.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL  
2021:092674, 17.05.2022

Gj y q t a r i  
Gent Bekeri

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë,  
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh  
nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes kësaj gjykate.